



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 48637 prot.

Tiranë, më 19.12.2024

V E N D I M

Nr.131, datë 18.12.2024

**“PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025 - 2027 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore, të ndryshuar, udhëzimit nr. 3, datë 28.02.2024, të ministrit të Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, udhëzimit plotësues nr. 8, datë 05.07.2024, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2025 - 2027 si më poshtë vijon:

1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2025 - 2027, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Lloji i të ardhurave	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
Të ardhura të taksueshme	12,914,000,000	14,284,000,000	13,713,150,000	13,848,587,500
Të ardhura jo tatimore	5,338,000,000	6,143,500,000	6,215,205,000	6,290,919,900
Total të ardhura	18,252,000,000	20,427,500,000	19,928,355,000	20,139,507,400
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	3,732,529,694	3,917,684,183	3,956,861,025	3,996,429,635
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	1,447,328,241	2,133,375,891	2,154,709,650	2,176,256,746
Total Transferta	5,179,857,935	6,051,060,074	6,111,570,675	6,172,686,382
Të ardhura të mbartura	10,000,000,000	12,100,000,000	4,900,000,000	3,600,000,000
Të ardhura të planifikuara nga donatorët	7,681,704	16,249,088		
Financime të Huaja	0	275,000,000		
Totali	33,439,539,639	38,869,809,162	30,939,925,675	29,912,193,782

1.2. Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2025 - 2027, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2024	Plan 2025	% ne strukturë	Plan 2026	Plan 2027
1	Shpenzime personeli	9,074,742,614	10,356,005,609	27%	10,272,506,681	10,272,506,681
2	Shpenzime të tjera operative	10,336,038,579	13,631,479,111	35%	11,579,298,082	11,416,522,499
3	Shpenzime kapitale	14,028,758,446	14,882,324,442	38%	9,088,120,912	8,223,164,602
	TOTALI	33,439,539,639	38,869,809,162	100%	30,939,925,675	29,912,193,782

2. Të miratojë buxhetin e Bashkisë së Tiranës si më poshtë:

2.1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.2. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.3. Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës nr.3, nr.3.1 dhe nr. 3.2, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.4. Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve buxhetore sipas pasqyrës nr.4, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.5. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2025.

3. Të miratojë Kalendarin e përgatitjes së Buxhetit të vitit 2026 si dhe të PBA 2026 - 2028.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Monitorimit të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik, Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisjes Elektronike dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësisve Administrative dhe Mbrojtjes Civile, si dhe institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2025.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO